REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KËSHILLI I MINISTRAVE**

# VENDIM

**Nr.** 285, **datë** 10.5.2019

**PËR**

## NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, e 28, pika 1, të ligjit nr.157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit ("Lista e OKB-së"), që i bashkëlidhet vendimit nr.718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës "C", të titulluar "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida", shtohet individi i renditur në shkronjën "a", sipas shtesës bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatës ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT**

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB-SË ("LISTA E OKB-SË")

**C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT ISIL (Da'esh) dhe AL-QAIDA**

**a)** Lista e shtuar në **"Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida";**

**1: MOHAMMED 2: MASOOD 3: AZHAR 4: ALVI**

Shënim: Gjenealitetet e tjera për personat dhe kompanitë, emrat e të cilëve janë radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

NR.PROT. 2471/1
DATË 10.5. 2019

MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PARANDALIMIT DHE PASTRIMIT TË PARAVE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjëll AGAÇI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI I MINISTRAVE